



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.439/2020
Data:20.01.2021

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dhjetë -X- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 29.12.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Sevime Laç (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Amir Bushi (Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Miratimi i planit të punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2021.
4. Miratimi i planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2021.
5. Miratimi i kërkesës së z.Avdi Dernjani për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
6. Miratimi i propozim vendimit për pagesën e shujtës për të gjithë të punësuarit në administratën e komunës.
7. Miratimi i draft rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
8. Miratimi i draft rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Hanumshahe Dibrani thekson:- kërkesë kam prej disa qytetarëve për transmetimin që është bërë drejtë për drejtë se nuk është dëgjuar dhe deshta të ju informojë.

Kryesuesi thekson:- e kam diskutuar këtë çështje por do të shikojmë mundësitë që ingjizimin me bërë më afër në mënyrë që me u dëgjuar më mirë.

Mehmet Ballazhi thekson:- pika e tretë të rendit të punës kërkoj që të hiqet krejt nga rendi i punës sepse i kam dhënë arsyet e mia në KPF por edhe nënkryetari i komunës ka potencuar që është kopi pastë nga viti i kaluar.

Kryesuesi thekson:- pika e tretë që është paraparë me u diskutuar është pikë e rregullt dhe ekzekutivi i komunës me këtë plan të punës do të punon për vitin 2021. A ka diskutime tjetër për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 12 për , 3 kundër (z.Mefail Suma- grupi parlamentarë Nisma, z. Mehmet Ballazhi dhe z.Florim Shkreta - grupi parlamentar i PDK-së).

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- gjatë muajit dhjetorë i kemi pasur gjithsejtë 10 raste dhe për momentin i kemi vetëm dy raste aktiv kurse tetë janë të shëruar. Nga muaji prill deri tash kemi gjithësejtë 77 raste pozitive. Në QKMF kemi filluar edhe me teste sterologjike që banorët e Hanit të Elezit kanë mundësi të i bëjnë testet sterologjike për kovid në QKMF-në dr.Menduh Kaloshi. Deri më tani janë kryer 468 teste e që prej tyre 43% llogaritet që e kanë kaluar virusin, 36 % që ende nuk e kanë kaluar dhe 21 % që faktikisht janë pozitiv. Përparësi për bërjen e testit ka pasur personeli shëndetësorë dhe personat të cilët ishin të dyshimtë, personat të cilët janë mbi moshën 60 vjeçare, zyrtarët komunal dhe stafi arsimorë i shkollave të komunës së Hanit të Elezit. Komuna i ka siguruar 3000 teste dhe testimet janë duke u kryer falas për të gjithë banorët e komunës së Hanit të Elezit.

Mefail Suma thekson:- në mjetet të nformimit kam dëgjuar që komuna e Prishtinës po ndanë mjete financiare për personat të cilët ishin të prekur nga kovidi , a ka mundësi edhe komuna e Hanit të Elezit me bërë këtë. QKMF-ja është duke u rinovuar dhe a do të ketë mundësi për fazën e dytë të jetë një mini spital i vogël që personat me sëmundje të kovidit të trajtohen këtu. Sa punëtorë kanë mbetur pa punë shkaku i kovidit dhe sa biznese janë mbyllur.

Hanumshahe Dibrani thekson:- si komunë shpresoj që ja kemi dal mirë me këtë pandemi dhe është bërë mirë që QKMF-ja ka filluar me i bërë testet sterologjike që kanë ndihmuar qytetarët e komunës sonë. Kërkoj nga kryetari i komunë që me ndarë një shumë të mjeteve financiare për qytetarët të cilët kanë qenë me kovid sikur kanë vepruar edhe disa komuna të tjera.

Florim Shkreta thekson:- komuna ka përfutur mjete financiare në emër të kovidit që një pjesë është paraparë për blerjen e një kamioni të mbeturinave, kërkoj sqarim për pjesën tjetër se ku është shpërndarë dhe a ka mbetur ende mjete financiare.

Sabedin Hasallari thekson:- sa është kapaciteti ditorë në QKMF për bërjen e testeve. Propozoj që heqja e taksës për bizneset të vazhdohet edhe për vitin 2021 se siç shihet kjo gjendje do të vazhdojë.

Medina Imishti thekson:- sa kam mundur me i përcjellë janë vetëm tri komuna që kanë ndarë mjete financiare për rastet të cilat kanë dalur pozitiv dhe nuk besoj që kemi mundësi me ndarë mjete për shkak se ka kaluar shpenzimi i mjeteve për këtë vit dhe nëse vazhdon situata e njëjtë në vitin e ardhshëm besoj që edhe ne do të bëjmë veprimin e njëjtë. Sa i përket minispitalit e kemi në plan pjesën e emergjencës me ndarë për trajtim të pacientëve me kovid por si ka me funksionuar nuk mund ta dimë por me gjithë atë është në plan të drejtorisë. Gjatë ditës bëhen 30 deri në 40 teste tu mos i anashkaluar analizat biokimisë të cilat bëhen.

Rufki Suma thekson:- sa i përket lirimit nga taksa duhet të shikohen mundësitë në vitin tjetër nëse eventualisht vazhdon do të marrim edhe ndonjë vendim tjetër në kuvend për këtë çështje. Mjete të cilat janë ndarë për kovid ishin 281000 € dhe saktësisht për mënyrën e shpenzimit do të paraqiten në raportin përfundimtarë të cilin do ta harton drejtoria për buxhet e financa

Sevime Laç thekson:- gjatë viti 2020 janë mbyllur dy biznese të cilat e kanë ushtruar veprimtarinë në autotaksi.

Florim Shkreta thekson:- mjetet financiare të cilat janë ndarë në emër të kovidit është dashur të orientohen në ato pjesë të cilat kanë pasur lidhje me kovid . Është dashur tu shpërndahet mjete financiare personave të cilët ishin të prekur me kovid dhe një pjesë është dashur me ua shpërndarë bizneseve , e jo të orientohen ato mjete financiare në kamionë të mbeturinave që faktikisht nuk ka qenë një kompani e cila e ka pasur gjendjen e dobët për me ndihmuar.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Miratimi i planit të punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Samire Curri thekson:- në kuadër të këtij plani te drejtoria e shëndetësisë propozoj që analizat T3 , T4 të kryhen në QKM për shkak se e njëjta kërkesë ishte edhe në mbledhje të komitetit për komunitete.

Nora Xhoni thekson:- përshëndes planin e ekzekutivit dhe të gjitha objektivat e drejtorive i përshtaten planit. Drejtoria për shëndetësi që planifikon ti përmbushë objektivat që një ndër to e cila me pëlqej ishte përgatitja e planit tre vjeçar për banim social 2021-2023.

Sabrije Krasniçi thekson:- duhet të përmirësohet viti 2019 ku shënon aktivitet për kulturë rini dhe sport. Kuvendi i Kosovës në vitin 2019 e ka miratuar një rezolutë kundër gjenocidit serb në Kosovë dhe është shënuar data 18 janari për këtë ditë. Te aktivitet për kulturë rini dhe sport me hyjë edhe kjo datë që komuna jonë si një lloj ekspozite me pasur që me i informuar të rinjtë për kohën e luftës. Është mirë me u caktuar data se kur është lëshuar për herë të parë treni dhe sipas informatave të mia që i kam stacioni i trenit është hapur në vitin 1874. Duhet me pasur një pllakë që shënon se kur është hapur stacioni i trenit për herë të parë . Komuna duhet ta ketë një hartë nostalgjike e cila i tregon se ku ka qenë fusha e sportit më herët , objekti i mirëqenies sociale , shtëpia e kulturës dhe të tjera për me i informuar të rinj se si ka qenë Hani i Elezit më herët. Kërkoj që çerdhja për fëmijë të emërtohet me një emër të përshtatshëm. Është mirë të kemi një lloj arti urbanë që i dedikohet kohës së luftës.

Sead Vila thekson:- sa i përket këtij plani për vitin 2021 ka shumë çështje të cilat janë të mirëseardhura nëse janë pjesë e realizimit për këtë vit vetëm që sa s'ka filluar, mirëpo unë kam identifikuar disa çështje të cilat ndoshta janë gabime teknike që shënon 20 vjetrit të rënies së dëshmorit Izet Bushi unë mendojë që është periudhë më e hershme por me siguri është gabim teknik. Te çështja e trajtimit të barabartë i skemës sociale barabarësia dhe drejtësia. Ne mund të jemi të barabartë në kushte dhe kritere por drejtësia nënkupton pastaj kriterin tjetër që e dallon, ka specifikat që mund ti ketë ndryshe. Faqe 13 kontrata për shërbime pika një dhe dy pse mos të jenë në një kategori por të ndahen kur ka të bëjë me shpenzimet brenda komunës. Te çështja që ka të bëjë me pranimin ndoshta mund të jenë dy çështje teknike 06 deri në pesë vite para shkollorë , a është fjala prej në gjashtë muaj apo është ndonjë specifikë tjetër. Është shënuar viti shkollorë 2020-2021 në fshatin Laç dhe Rezhancë mendojë që është një gabim teknik dhe është mirë të përmirësohet. Te plani i drejtorisë së arsimit për vitin 2021 shënon që është punësuar një asistente dhe parashihet të punësohet edhe një tjetër gjatë vitit 2021 por nuk specifikohet që është me kontratë vetëm për shkollën “Ilaz Thaçi” dhe nëse ka të bëjë për

krejt komunën do të ishte mirë që punët ti kryen edhe në shkollat e tjera. Është potencuar çështja e zhvillimit profesionalë e cila më pëlqen duke filluar prej shkollës sime por edhe për shkollat tjerë, mirëpo është një hezitim i mësimdhënësve me ndjekur trajnime për me shkuar dhe me u zhvilluar profesionalisht. Do të ishte mirë që kjo pjesë e cila është paraqitur në këtë plan të jetë nxitëse i drejtorisë së arsimit të drejtorët dhe mësimdhënësit në mënyrë që me marr më me përkushtim e jo me i ikur , për shkak se kemi një numër më të madh të mësimdhënësve që i refuzojnë trajnime. Sa i përket drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale ndoshta ka të bëjë te raporti por asnjë herë nuk po e cekë numrin e përfituesve të asistencës sociale dhe është mirë ta dimë si anëtarë të kuvendit se a përpunohen të dhënat sepse gjendja ekonomiko sociale mund të ndryshon në aspektin kohorë të familjet e caktuara. Sa i përket mjekëve specialistë, stomatologë, gjinekologë, peditër është diskutuar disa herë , mirëpo për mua do të ishte e mirëseardhur që përveç farmacistes të gjenden edhe mundësi që të pranohen edhe specialistët të tjerë që ne si qytetarë të komunës sonë të kemi mundësi me kryer shërbime dhe nëse nuk ka mundësi të gjitha profilet të paktën të ketë një stomatologë. Te drejtoria e arsimit raporti fletë për vitin 2020 , ndërsa plani bëhet fjalë për vitin 2021. Kërkoj sqarim për çështjen e tarifave të larta të legalizimit të objekteve të ndërtimit se qytetarët a janë duke i kryer pagesat apo hezitojnë për shkak të çmimit të lartë që nuk korenspondonë me gjendjen ekonomike tonën. Te drejtoria për zhvillim ekonomik e shikova planin teorikë dhe shumë më pëlqejti por nuk e pashë se si është menduar shtrirja buxhetore e shfrytëzimit dhe kisha dashur me parë një pasqyrë të shpenzimit të mjeteve për vitin 2021.

Teuta Shkreta thekson:- a kemi ndonjë person që merret me vlerat historike , me luftën e lavdishme por kërkojë nga sodë të caktohet një person në mënyrë që të shkruhet lufta e lavdishme e UÇK-së dhe data e rëndësishme.

Mefail Suma thekson:- vërejtje kam te organogrami i komunës së Hanit të Elezit që është shënuar me katërkëndësja me ngjyra të ndryshme dhe janë edhe vijat të cilat e orientojnë shërbimet se kujt i përket, mirëpo më shumë vërejtje kam te ngjyrat. Personi që e ka bërë këtë a e ka bërë organogramin sipas dëshirës së vet apo është ndonjë udhëzim në formë të shkruar se kjo duhet të jetë në këtë formë të shkruarit për shkak se nuk më pëlqen katërkëndëshi që është kryetari i komunës me ngjyrë të kuqe dhe kërkoj sqarim se pse është bërë me këtë ngjyrë për shkak se të gjithë e dimë që ngjyra e kuqe tregon rrezikun. Në Komitet për Politik e Financa ishte bërë shumë fjalë për çështjen e ujit dhe shihet se në atë mbledhje ka marr pjesë vetëm z.Mehmet Ballazhi dhe askush nuk ka diskutuar por me që edhe unë jam opozitë rrjedhë që vetëm opozita pinë ujë. Kur e kam kërkuar marrëveshjen me kompaninë “Bifurkacioni” më është ofruar marrëveshja dhe minimumi ka qenë gjashtë muaj që i kish skaduar afati. A është bërë ndonjë marrëveshje e dytë dhe nënkryetari i komunës kish potencuar në KPF se kompania “Bifurkacioni” do ti jep 300 000 € por në marrëveshje nuk shënon. Në marrëveshje potencohet se kompania “Bifurkacioni” do të i menaxhon vetëm asetet e komunës që ekzistojnë. Shumë vite flitet për kompaninë “Bifurkacioni” dhe ju jeni duke e paraqitur kushledër këtë kompani por kjo vetëm është për me inkasuar mjetet. Do të ishte mirë që nga kjo kompani me ardhur dikush në kuvendin e komunës dhe me treguar për çështje të çmimeve, sa mjete financiare grumbullohen në Han të Elezit për shpenzimet e ujit, sa mbeten dhe sa shpenzohen. Me që është pronë private stacioni ku akumulohet uji dikush për atë merr mjete financiare dhe ju mund të potencoi se nuk është kompetencë e komunës por nëse nuk është kompetencë e komunës sa paguhet ai person dhe ndoshta nuk merr mjete hiq por dua ta dijë si informacion. Edhe në seancën e kaluar e kam parashtruar si pyetje për çështjen e ujës-jellësit të Gllloboqicës për shkak se ka ankesa nga qytetarët se ka reduktime një orë apo dy në mëngjes ka ujë dhe një orë apo dy në mbrëmje. Diskutohet se në Han të Elezit ka ujë mjaft por a është ujë me cilësi siç e kërkojnë parametrat dhe vetëm potencohet që do të bëhet uji nga përroi i fshatit Dimcë , ndërsa në marrëveshje nuk përmendet fare aseti i cili është në marrëveshje që është fabrika e ujit, por nuk është fabrikë e ujit se asgjë nuk fabrikohet mos i mashtroni qytetarët për shkak se uji nuk fabrikohet por vjen ashtu siç buron. Kërkoj që mjetet financiare që i keni paraparë në shumë prej 330 000 € me i ndarë për çështje të ujit apo për ndërtimin e një banese në mënyrë që me ua ndarë personave të cilët kanë nevojë. Në plan është paraqitur zhvillimi profesional i punëtorëve të arsimit ata janë të zhvilluar profesionalisht por kanë nevojë për trajnim dhe asnjë herë nuk e keni paraqitur se sa herë kanë qenë në trajnime profesionale dhe ku është suksesi. Unë nuk do ta votoj planin e kryetarit të komunës për vitin 2021 për shkak se ka shumë të meta.

Florim Shkreta thekson:- çështja emrit të çerdhes edhe sa kohë duhet të jetë pa emër dhe si do të shkojnë procedurat. A është pranuar teknikisht çerdhja.

Sabedin Hasallari thekson:- kur është miratuar buxheti për vitin 2021 e kam ngritur çështjen e ujit për shkak se ka qenë prioritet mbi prioritet për qytetarët e komunës së Hanit të Elezit.

Mefail Suma thekson:- për çështjen e ujit unë potencove për në komitet për politik e financa sepse përveç z.Mehmet Ballazhi nuk kish diskutuar tjetër kush.

Rufki Suma thekson:- çështjen e ujit e kemi biseduar disa herë dhe është diskutuar për çdo vit gati se në çdo mbledhje të kuvendit të komunës. Marrëveshjet të cilat i kemi pasur me kompaninë “Bifurkacioni “ dhe zyrën Zvicerane CDI shumë herë nuk ju kanë përmbajtur se po të ju ish përmbajtur kompania “Bifurkacioni “ në vitin 2010 ishte kryer çështja e ujit. Është ndërtuar fabrika për trajtimin e ujit e jo për prodhimin e ujit por për shkak se nuk ka pasur mbikëqyrje është mbyllur fabrika. Vitin e kaluar kur është miratuar buxheti i komunës për vitin 2021 kemi pasur mjete të planifikuar edhe më shumë se sa kemi ndarë për çështje të ujit por pasi nuk kemi pasur marrëveshje të nënshkruar me askënd i kemi hequr disa mjete financiare dhe po që se ta kishim ditur sa pas dy jave pasi e kemi miratuar buxhetin do të nënshkruanim marrëveshjen me zyrën Zvicerane dhe me kompania “Bifurkacioni” me siguri me kohë i kishim paraparë mjetet financiare për ujin dhe i kishim hequr edhe disa projekte të tjera. Marrëveshjen e fundit të cilën e kemi bërë me zyrën Zvicerane dhe kompanisë “Bifurkacioni “ ka qenë që të bëhet projekti detal për trajtimin e ujit nga burimi i fshatit Dimcë dhe është bërë projekti përmes zyrës Zvicerane. Projekti detal parashihet prej hyrjes së ujit në fabrikë për trajtim, parashihet vendosja e orëmatësve, ndërrimi i gypave ku është e nevojshme dhe gjithçka që ka nevojë një vlerësim preliminarë. Në bazë të atij projekti është nënshkruar një marrëveshjen në mes komunës, zyrës Zvicerane dhe kompanisë “Bifurkacioni “. Zyra Zvicerane ka marr për obligim që këtë projekt me financuar me mjete financiare në vlerë prej 300 000 €, ndërsa komuna ka marr për obligim që çdo shumë e mjeteve që e kalon 300 000 € dhe sa do që shikon mjetet financiare me i siguruar komuna, ndërsa kompania “Bifurkacioni “ ka për obligim mirëmbajtjen dhe trajtimin ujit. Kjo është marrëveshja e mjeteve që e kena nënshkruar pasi është miratuar buxheti i komunës dhe në momentin që do të bëhet bartja e mjeteve financiare në muajin shkurt të viti 2021 do të i bartim mjetet financiare për çështjen e ujit për shkak se nuk kemi mjete financiare të mjaftueshme. Marrëveshja e fundit është nënshkruar para dy apo tre muaje , ndërsa marrëveshjet e më parshme nuk janë në fuqi. Sa i përket shënimit të përvjetorit të Izet Bushi mund të jetë gabim teknik për shkak se në vitin 2021 është tridhjetë vjetori dhe është vit jubilarë. Kjo është plan dhe nuk kemi planifikuar diçka që mendojmë që nuk mund ta realizojmë por sa i përket gjenocidit është mirë të përkujtohet çdo ngjarje që është që është në kuadër të nivelit qendrorë me ligj e përcaktuar është e mirë që të paktën të përkujtohet. Për përkujtimin e gjenocidit është treni muze “Bllaca 99 “ që në vitin e ardhshëm do të ketë manifestim për shkak se aty është punuar muri i kujtesës që do të bëhet përrurimi në muajin prill. Vitet e më hershme kur ka qenë java kulturore për nder të ditës së çlirimit për çdo vit kemi pasur ekspozita të ndryshme. Çdo herë kur ka të bëjë me vlerat e luftës kemi shkuar në aspektin e shoqatave të dalura nga lufta të cilave ua kemi lanë prioritet apo shkrimet të cilat janë marr rreth ngjarjeve të luftës, mirëpo po që se do të kemi institut të historisë si duhet në nivel të Kosovës do të ishte mirë që të bëhet një libër që e trajton luftën e UÇK-së në mënyrë shkencore e jo me ju lënë mundësi individëve e pastaj me pasur gabime por fatmirësisht këtë zbrastirë në Han të Elezit e ka mbuluar z.Shaban Qupi i cili ka botuar libra që kanë të bëjnë me luftën. Çerdhja është në prag të licencimit dhe është pranuar kuadri por drejtori nuk është pranuar për shkak të procedurave që kërkohen ende nuk është zgjedhur. Çerdhja duhet të ketë emërtim por emërtimin e bënë këshilli i punëtorëve të cilët ja propozojnë Ministrisë së Arsimit dhe Ministria e miraton.

Sevime Laçi thekson:- në buxhetin e drejtorisë për zhvillim ekonomik janë të përfshira pagat dhe mëditjet 21,196.00 € dhe mallra e shërbime. Kur kemi mbështetje prej organizatave të ndryshme komuna bashkë finaconë dhe mjetet financiare i merr nga zyra e kryetarit të komunës.

Florim Shkreta thekson:- sa i përket çerdhes a mendoni që është e drejtë me vendosë për një emër këshilli i punëtorëve dhe a do të ishte më e drejtë që të del në debat publik apo edhe në instanca të ndryshme.

Menduh Vlasi thekson:- u potencua që për çerdhen të jetë një emër më i mirë por unë e di që ende nuk ka emër çerdhja. Emërtimi nuk është bërë dhe as që është diskutuar se si do të bëhet për arsye se ekziston udhëzimi administrativ për emërtim të institucioneve arsimore. Sa i përket pyetjes së z.Sead Vila me udhëzim shënon 06 deri në 6 vjet por e heq sepse nuk ekziston 6 vjet për shkak se shkojnë në klasën e parë. Në çerdhe do të pranohen fëmijët nga 06 muaj deri në katër vite, ndërsa pesë vjeçarët shkojnë në parafillorë. Për çështje të asistentëve neve na u ka lejuar me u pranuar një asistente dhe po shpresojmë që ta pranojmë edhe një asistente e cila do të jetë në shërbim të fëmijëve ku do që janë brenda komunës . Për çdo vit kemi potencuar për çështjen e zhvillimit profesional për të cilën mendojmë se nuk duhet të ndalet kurrë se pavarësisht se e ka fakultetin duhet të ngritët vazhdimisht në aspektin profesional përmes trajnimeve të ndryshme. Të arriturat i shënojmë në raport të cilin do ta keni në muajin shkurtë por ky është plan i punës.

Nexhmedin Daci thekson:- taksat e legalizimit janë unike në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Për shtëpitë individuale taksa është një euro për metër katrorë, për objektet kundër zjarreve tri euro për metër katrorë , për objektet me leje ndërtimore ku ka pasur ndërtime 2 euro për metër katrorë. Shërbimet gjeodezike janë kompani të licencuar prej Agjencionit Kadastral të Kosovës dhe i kanë tarifën e tyre. Çmimi që i kryejnë për shërbime gjeodezike është një euro për metër katrorë dhe komuna nuk mund të ketë ndikim për çështjen e çmimeve.

Medina Imishti thekson:-qe tri vite në plan të punës e kemi si objektiv ngritjen e specialistëve në komunën tonë dhe kemi një pediatër dhe një internistë. Gjatë viti janë pesë apo gjashtë kërkesa në Ministri të Shëndetësi për ngritje të stafit por nuk kemi marr asnjë përgjigje. Për vitin 2021 kemi planifikuar me ngritë numrin e specialistëve. Analizat T3 dhe T4 kur është miratuar rregullorja për taksa dhe tarifa kemi potencuar që për herë të parë do të bëhen këto analiza në komunën tonë për shkak të ngarkesës që laboratorit e ka pas dhe nuk e kemi bërë njoftimin as të mjekët që me ju referuar pacientëve për këto analiza. Në raport të punës e paraqesim saktë numrin e familjeve me asistencë sociale dhe ne nuk mund ta planifikojmë se sa persona do të kenë nevojë për ndihmë sociale. Në praktikën tonë të punës po mundohemi me pasur drejtësi edhe barazi. Për shkak të situatës me covid është dashur shumë detyra me i lënë por po besoj që në vitin e ardhshëm do të bëhet plani tre vjeçar për banim social.

Teuta Shkreta thekson:- kur kemi ndonjë manifestim për muajin shkurtë , mars apo nëntor ne të caktohet një person dhe ta shënon se çka ka qenë në atë kohë dhe përgjegjësia të jetë për atë person, në mënyrë se si kanë qenë ne të rrjedhin gjërat.

Sabrije Krasniqi thekson:-çështja e gjenocidit serbë unë mendoj që duhet të jetë te aktivitetet si datë dhe unë mendoj që edhe te treni me u bërë një lloj ekspozite e fotove për luftën por është mirë që ta dinë çdo kush që ajo datë të jetë. Nga drejtoria për arsim kisha kërkuar që me vendosë një pllakë te stacioni i trenit dhe të jetë e shënuar data se kur është hapur për herë të parë stacioni i trenit sepse shumë pak qytetarë e dinë këtë. Me pasur një lloj arti urban dhe një hartë nostalgjike që me treguar kohën e më hershme Hani i Elezit si ka qenë .

Menduh Vlasi thekson:- vendosja e një pllake te stacioni i trenit dhe harta nostalgjike po më pëlqen me i bërë por krejt këto kanë kosto buxhetore dhe ju e keni miratuar buxhetin dhe në buxhet duhet të planifikohen mjetet financiare. Ne sot kot mundemi me shtijë në plan kur e dimë që nuk kemi mjete financiare për këto çështje. Si këshilltarë do të ishte mirë që kur të miratohet buxheti me i planifikuar këto gjëra dhe në plan jemi bazuar në bazë të buxhetit që e kemi.

Nora Xhoni thekson:- në komunë tonë nga pas lufta çdo detaj i vogël është përkujtuar dhe kjo më së shumti e dëshmojnë edhe foto në këtë sall të kuvendit të komunës, në koridorë , jashtë komunës dhe po të i shikosh emrat e rrugëve janë të emërtuara me emra të dëshmorëve. Në të ardhme duhet një zyrtarë me u përcaktuar për këtë çështje në mënyrë që me pas një libër për komunën tonë por edhe kryetari potencoj që i takon instancave të shtetit që të merren me këtë çështje që të bëjnë ndonjë libër shkencor që gjeneratave të reja të ju shërbejë si lëndë në shkollë në mënyrë që të mësohet historia.

Sabedin Hasallari thekson:- a jeni i sigurt si kryetar i komunës që do të zgjidhet problemi i ujit në komunën e Hanit të Elezit pas këtyre marrëveshjeve që i keni bërë sepse po kam frikë se do të bëhet ndonjë investim sikur më parë dhe përsëri problemi i ujit nuk do të zgjidhet.

Rufki Suma thekson:- ne mund të bisedojmë dhe garantojmë vetëm për mjetet financiare që i ka komuna, mirëpo për derisa ata e shpallin tenderin dhe i ka dështuar. Në hapje të ofertave ka marrë pjesë edhe zyrtari i jonë i prokurimit dhe pjesëmarrës kanë qenë dy kompani dhe më vonë na kanë njoftuar që ka dështuar tenderi për këtë çështje. Në bisedat që i kam pasur me zyrtarët e asaj zyre kanë potencuar që do ta ripërsërisin tenderin por nuk mund të i besojmë sepse shumë herë nuk i kanë kryer punët. Nëse eventualisht rishpallet tenderi dhe e përcaktojnë atëherë kemi obligim për gjetjen e mjeteve financiare për me kryer pjesën tonë. Për derisa nuk i kemi mjetet tona financiare dhe nuk e shpallim vetë tenderi nuk mund të garantojmë asgjë.

Hanumshahe Dibrani thekson:- pasi është bërë punësimi i gjinisë femërore në çerdhe është mirë që edhe emri i çerddes t'i vendoset i gjinisë femërore.

Mefail Suma thekson:- më pëlqejë propozimi i znj. Teuta Shkreta për shkak se shumë gjëra harrohen sepse historin nuk e shkruajnë ata të cilët ishin në luftë por ata të cilët kanë këqyr. Unë kam punuar me z. Jahush Shkreta i cili më ka treguar shumë gjëra por që askund nuk fliten dhe janë fakte burrërore që kanë ndodhur gjatë kohës së luftës. Është mirë të caktohet një person dhe të jetë gjuhëtarë apo historianë dhe me i grumbulluar nëpër të gjitha fshatrat gojëdhënat dhe pastaj një trup shkencorë e përpunon. U potencua që kemi fotografi por pikërisht për Hanin e Elezit kemi shumë pak dhe duhet më shumë të ketë. Në kohën kur ka luftuar Dergut Pasha në Kaçanik ka pasur luftarë edhe nga Hani i Elezit prej fshatit Dimcë me emra i di personat të cilët kanë marrë pjesë. Prej se jam asambleistë asnjë herë nuk është dërguar plani i punësimit. A keni në plan të punësoni në vitin 2021 dhe a do të i merrni me nepotizëm apo do të punësoni dekind prej opozitës.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rregulloren; rezultati i votimit ishte 11 për, 4 kundër (një nga grupi parlamentarë Nisma, tre nga grupi parlamentarë i PDK-së).

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021

4. Miratimi i planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- në të gjitha takimet që i mbajmë çdo herë diskutohet çështja e sigurisë. Sipas udhëzimit administrativ plani i KKS-së duhet të miratohet në kuvend. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo plotësim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- është një shtëpi në fshatin Dimcë shumë e vjetër e cila është gati për rrënim por unë propozoj që mos me rrënuar por me pasur mjete financiare është mirë të rregullohet dhe të mbetet si monument historikë i banesave të vjetra që kanë qenë.

Florim Shkreta thekson:- në plan i kanë paraqitur pikat dhe kanë paraparë gjëra të cilat ndoshta janë edhe të kryera ose nuk mund të bëjnë zgjidhje për ato pika. Do të ishte e duhur që në plan të jetë si pikë rrezikimi prej qenve endacak, rrezikimi në rrugën Hani i Elezit-Gorancë ku janë duke u kryer punimet që është hedhur dheu në prurje e që është një shqetësim për banorët e Lagjes së Re. Po ashtu është rrezik edhe për banorët të cilët jetojnë në hekurudhë për shkak se mbikalimi është i pa përshtatshëm dhe mendoj që është e nevojshme të planifikohet një nënkallim apo një zgjidhje tjetër të bëhet. Sensibilizimi dhe parandalimi i narkotikëve dhe duhanit në mbledhjen e fundit kam diskutuar për këtë pikë por në KKS kryetari i komunës ka potencuar se ai e bënë për poena politik dhe nuk më ka pëlqyer ky gjest i kryetarit sepse asnjë herë nuk e fajësojë as kryetarin apo as dikën tjetër për këtë dukuri por është mirë të bëhemi bashkë dhe ta luftojmë këtë dukuri. Rasti është i vërtetë dhe është në procedurë por nëse nuk ka qenë i njoftuar komandanti e ka pranuar se nuk ka qenë i njoftuar por kryetari nuk më ka besuar që unë jam te diskutuar një diçka që ka qenë realitet sepse vetë i shtati kam qenë ka pasur edhe dëshmitarë.

Mehmet Ballazhi thekson:- është paraparë si pikë e rendit të ditës luftimi i ekstremizmit të dhunshëm në KPF potencova që të jetë luftimi i ekstremizmit dhe unë mendoj që më mirë do të ishte parandalimi i ekstremizmit . Unë kam kërkuar që mos ta sjellin në kuvend për miratim për shkak se nuk po na raportojnë dhe nuk po e dimë se çka po ndodhë. Është mirë që të na raportojnë në formë tabelare për gjërat të cilat kanë ndodhur dhe diskutimet që janë bërë.

Rufki Suma thekson:- trajtimin e qenve endacak e kemi hequr nga plani se realisht nuk jemi duke pasur se çka të bëjmë me këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2021

5. Miratimi i kërkesës së z.Avdi Dernjani për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- kërkesa është bërë për ndërrim destinim të pronës dhe është mirë që po ju nënshtrohen procedurave për me kërkuar lejen ndërtimore. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E AVDI DERNJANI PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

6. Miratimi i propozim vendimit për pagesën e shujtës për të gjithë të punësuarit në administratën e komunës.

Kryesuesi thekson:- propozim i ekzekutivit është që t'i shtohet edhe për vitet në vazhdim për shkak se nuk bëhet fjalë vetëm për vitin 2020. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- stafi civil ka parashtruar kërkesë për pagesën e shujtave dhe nëse nuk kemi ndonjë pengesë nga niveli qendrorë të kryhet pagesa për shujtat për vitin 2020 dhe të vazhdohet për vitet në vijim. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Sead Vila thekson:- unë jam që të ju kryhet pagesa e shujtave stafit komunal sepse ju takon. A është procedura e njëjtë sikur në sektorin e arsimit që u pengua apo ka ndonjë burim tjetër. A bëhet fjalë për tridhjetë persona apo mund të jetë numri më i madh e kjo është vetëm listë inicuese. Kërkoj sqarim nga drejtorja e financave se çka ka mbetur nga ana ligjore dhe a janë mbyllë mundësit apo ka akoma ndonjë mundësi për shujtat e mësimdhënësve.

Mefail Suma thekson:- unë e përkrahi këtë propozim vendim edhe në aspektin moral por kërkoj asnjë shërbim mos mbetet anash të përfshihen të gjitha shërbim për pagesën e shujtës por duhet të përfshihet edhe shërbimi i pastrimit. Nëse nuk bëhet ndonjë shkelje ligjore kërkoj që ky vendim të mbetet çdo herë.

Sabedin Hasallari thekson:- e përkrahi këtë propozim vendim që të përfshihen të gjitha kategoritë në pagesën e shujtave dhe tu paguhet edhe punëtorëve e kompanisë pastrimi.

Rufki Suma thekson:- ne kemi dashur që fillimisht me kryer punën me sektorin e arsimit dhe nuk ka ndonjë përgjigje prej nivelit qendrorë por vetëm na i bllokoi rrugët dhe i kemi orientuar që me i vazhduar procedurat përmes gjykatave. Këtu bëhet fjalë për të gjithë stafin publik që e ka komuna dhe kompania publike është me një qind për qind me aksione të komunës dhe e ka më lehtë sepse komisioni i aksionarëve e autorizon bordin e drejtorëve që me marr vendim për këtë çështje

Mefail Suma thekson:- AKP-ja i ka borxh punëtorëve dhe të gjithë punëtorët i kanë vendimet për dëmshpërblim dhe që dhjetë vite nuk i kemi marr. Me që e lexova që kryetari i komunës mundë të bashkëpunonë me secilën ministria dhe besoj që mund të bashkëpunon me AKP-në për me na i lëshuar mjetet financiare.

Shabi Rexhallari thekson:- vendimin e shujtave në arsim për vitin 2017 e kemi përcjell në ministri por përgjigje pozitive dhe negative nuk kemi marr. Në listat të pagave e kemi parë që nuk ishte procesuar që do të thotë për vitin 2020 nuk ka diçka konkrete. Për vitin 2021 ka gjasë me ju bërë kërkesë dhe me pritë dy apo tre muaj dhe me ju sugjeruar që të veprojnë me procedura të tjera. Sa i përket kompanisë nuk kemi të drejtë me i dedikuar mjete financiare për shujtat por kur është miratuar planin financiar i kompanisë e kanë paraparë edhe pagesën e shujtave.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VEDNIMI PËR PAGESËN E SHUJTAVE PËR TË GJITHË TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN E KOMUNËS

7. Miratimi i draft rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Kryesuesi thekson:- rregullorja i ka kaluar procedurat është shqyrtuar në komitet për politik e financa dhe në kuvendin e komunës dhe është përcjell për miratim në këtë mbledhje. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:-unë por them që mos është bartje e kompetencave me ua deleguar drejtorëve dhe për këtë çështje ligjet nuk i kam lexuar por është mirë që të bëhet një trajnim lidhur me këtë çështje në mënyrë që të jemi më të informuar personat se çka kanë të drejtë dhe çka nuk kanë të drejtë. Janë shënuar nenet të cilat i përcakton ligji por nuk janë shënuar nenet që parashihen në statut dhe unë mendojë që në statut mungojnë shumë gjëra dhe nëse janë në ligj është mirë me i përfshirë edhe në rregullore.

Kryesuesi thekson:-në statutin e komunës nuk mund të përfshihen të gjitha gjërat por lëshohet vetëm në kapituj në imësira nuk mundemi me i përfshirë të gjitha. Statuti nënkuptohet që është akt më i lartë i komunës dhe lëshohen në akte më të ulët dhe kjo rregullore bazohet edhe në statut të komunës por imësirat nuk mund të parashihen.

Bajrush Laçi thekson:- rregullorja i ka kaluar gjitha procedurat dhe ju njoftojë se asociacioni i komunave të Kosovës në bashkëpunim me zyrat ligjore e ka punuar këtë rregullore për arsye se neni shtatë i ligjit për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës komunale i jep të drejtë komunave që ta hartojnë një rregullore për pronat në shfrytëzim më pak se një vit. Asociacioni me zyrat ligjore e ka përgatitur këtë rregullore dhe e ka përcjell te të gjitha komunat. Statuti i komunës nuk është përfshirë për shkak se kjo është propozuar si model për të gjitha komunat por në momentin që do të miratohet në kuvendin e komunës në preambulë do të shënohet edhe statuti i komunës që i ka dispozitat ligjore. Nuk ka ndonjë problem ligjorë për dhënien në shfrytëzim të pronave më pak se një vit dhe për këtë garanc jep zyra ligjore.

Mefail Suma thekson:- lokalet të cilat janë a kanë kontratë me komunën apo si e kanë të rregulluar çështjen.

Bajrush Laçi thekson:- drejtoria e urbanizmit u jep kontratë për çdo vit sikur ka qenë prej komunës së Kaçanikut që janë bartur prej atje dhe vazhdimisht ka vazhduar por problematika është se lokalet i kanë ndërtuar banorët vetë. Me ligj të ri është me ankand publik por me këtë rregullore është marr që me ua rregulluar statusin e tyre dhe në momentin që ka ndonjë plan prej komunës njoftohen brenda tridhjetë ditëve që të rrënohen ato objekte.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për, 1 abstenim (z.Florim Shkreta).

U MIRATUA DRAFT RREGULLORJA PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PASK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

8. Miratimi i draft rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Amir Bushi thekson:- përveq materialeve të dërguara nuk kam diçka të veçantë.

Florim Shkreta thekson:- Komuna e Hanit të Elezit e përkushtuar në zbatimin e konceptit: Komunë mike për fëmijë. Pika 1.1 ndjehet i sigurt në rrugë, shkollë dhe në mjedisin ku jeton por fëmijët nuk kanë siguri në rrugë për shkak se bredhin shumë qenët endacak. Pika 1.12 mbrohet nga shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, dhuna, abuzimi apo çfarëdo rreziku tjetër që mund të vijë si rezultat i moshës apo gjinisë, unë mendoj që edhe në këtë pikë fëmijët nuk mbrohen për shkak se fëmijët mitur qe shumë vite bredhin te kufiri. Pika 1.3 të ketë qasje në burime të ujit të pastër dhe të jetojë në një mjedis të pastër dhe me hapësira të gjelbra, edhe me këtë pikë nuk pajtohem për shkak se as nëpër shkolla nuk ka ujë të pastër.

Amir Bushi thekson:- kjo është vetëm një rregullore dhe nuk është raport dhe nëse kryetari e formon grupin dhe zyrtari i cili caktohet për këtë çështje brenda një viti e ka për obligim me raportuar dhe mund të parashtrihen vërejtjet për çdo drejtori

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për, 1 abstenim (z.Florim Shkreta).

U MIRATUA DRAFT RREGULLORJA PËR PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hanumshahe Dibrani thekson:- për emrin e çerdhes propozoj të vendoste emri i bashkëshortes së z.Nurim Bravës e cila ka kontribuar gjatë luftës për ushtarët e UÇK-së.

Menduh Vlasi thekson:- dëshirë kemi për propozime të emrave por duhet të respektohet udhëzimi administrativ.

Sead Vila thekson:-unë si asamblistë ka qe një vit që jam zgjedh anëtarë i kuvendit e kam hasur te rregullorja e kuvendit të komunës që duhet të jetë një përfaqësim te komitet nga të gjitha subjektet politike dhe përfaqësimi gjinorë për shkak se në aspektin ligjorë jemi dy subjekte të përfaqësuara.

Mehmet Ballazhi thekson:- një pyetje që ja kam parashtruar drejtorit të financave për çështje të pronës dhe tatimit në pronë për te ndërtesa e të vetmuarve të cilët paguajnë edhe tatim në pronë por edhe qiranë. Atë ditë kur ka qenë ky biznesmeni Sadat Peker kryetari i komunës a ka pasur njohuri. Përcjellja e policisë a ka qenë protokollare apo ka qenë private që përmes një telefonate me dal me i përcjellë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:57.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava